



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KORÇË
KRYETARI

DREJTORIA E FINANCËS

Nr. 10206 prot.

Korçë, më 04 . 11 .2019

URDHËR

Nr. 959 , datë 04 . 11 .2019

P Ë R
PAGESËN E BURSAVE PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME TË
PËRGJITHSHME

Bazuar në ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 64 "Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë", ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin nr. 99/2018 datë 03.12.2018 "Për buxhetin e vitit 2019", udhëzimin nr.2 datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, VKB nr. 152 datë 27.12.2018 "Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2019 të Bashkisë Korçë", udhëzimin plotësues nr. 1 datë 17.01.2019 "Zbatimin e buxhetit të vitit 2019", VKM nr.776 datë 26.12.2018 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënës të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2018-2019", VKB Bashkia Korçë nr. 5 datë 31.01.2019, Për miratimin e bursave të studimit për nxënës për vitin shkollor 2018-2019", VKB Bashkia Maliq nr. 3 datë 28.01.2019 "Për ndarjen e planit të bursave për nxënës të arsimit parauniversitar dhe arsimit të mesëm profesional viti shkollor 2018-2019" si dhe VKB Bashkia Maliq nr. 38 datë 25.02.2019 "Për ndarjen e planit të bursave për nxënës të arsimit parauniversitar dhe arsimit të mesëm profesional viti shkollor 2018-2019".

URDHËROJ:

1. Të kryhet pagesa e bursave për nxënës të Shkollave të Mesme për periudhën **Janar 2019**, në vlerën **494,030 lekë**.
 - Shkolla e Mesme të Përgjithshme "Raqi Qirinxhi" në vlerën 145,894 lekë
 - Shkolla e Mesme të Përgjithshme "Themistokli Gërmenji" në vlerën 170,676 lekë
 - Shkolla e Mesme të Përgjithshme "Ymer Dishnica" në vlerën 93,527 lekë
 - Shkolla e Mesme me orientim gjuhësor "Faik Konica" në vlerën 83,933 lekë
2. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Financës.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: Kristina Kamenica
Drejtoresh: Valbona Ziko

KRYETARI I BASHKISË
Sotiraq Filo

